



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2024:149458

Datë: 05.08.2024

Numri i dokumentit: 06019544

**2024:149459**

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA NË KAÇANIK**, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Indira Beqa, në lëndën penale kundër të pandehurit H.B nga Kaçaniku, për veprë penale, Kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.717/24 e datës 24.05.2024, jashtë seancës gjyqësore me 05.08.2024 merr këtë,

**A K T V E N D I M**

**HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP.nr.717/24 e datës 24.05.2024, e parashtruar kundër të pandehurit H.B nga Kaçaniku, për shkak të dyshimit se:

Me datë 08.05.2024, rreth orës 15:45, pranë brezit kufitar të Republikës së Kosovës -Maqedonisë së Veriut, afër pikë-kalimit kufitar në Han të Elezit saktësisht në fshatin Seqishtë, rruga "Eksodi 99", i pandehuri në vendkalimin e paautorizuar kufitar duke iu shmangur pikës së kontrollit kufitar, ka kaluar në mënyrë ilegale nga Republika e Maqedonisë Veriore për në territorin e Republikës së Kosovës përmes rrugëve ilegale të fshatit Bllacë të Maqedonisë së Veriut në afërsi të pikës kufitare të Hanit të Elezit, e pastaj ndalohej për kontroll nga Policia e Republikës së Kosovës dhe të njëjtin e kanë shoqëruar për në Stacionin Policor MK në Han të Elezit.

Me të cilën do të kryente veprën penale, Kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.1 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës bien në ngarkim të mjeteve buxhetore të gjykatës.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka parashtruar pranë kësaj gjykate aktakuzën PP.nr.717/24 e datës 24.05.2024, kundër të pandehurit H.B nga Kaçaniku, për vepër penale, Kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.1 te KPRK-së.

Ne bazë të kësaj aktakuze, gjykata duke u përgaditur për caktimin dhe mbajtjen e shqyrtimit fillestar, nga ana e familjarëve të të pandehurit, ka pranuar një certifikatë të vdekjes me nr.... të dt.16.07.2024 të lëshuar në Agjensia për Regjistrim Civil në Prishtinë. nga e cila gjykata ka konstatuar se i pandehuri është i vdekur.

Andaj gjykata, bazuar në certifikatën e vdekjes me nr...., lëshuar në Agjensia për Regjistrim Civil në Prishtinë me dt.16.07.2024, konstatoi se i pandehuri H. ( I... ) B i lindur me dt.... ne Prishtinë, me adresë të fundit të banimit në Kaçanik, ka vdekur me ... në Kaçanik.

Meqenëse vdekja e të pandehurit është pengese për ndjekje penale, gjykata vendosi që t'a Hudh aktakuzën PP.717/24 e datës 24.05.2024

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 454 par.1 të KPRK,se Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### **GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

#### **DEGA KAÇANIK**

**2024:149459 date 05.10.2024**

Sekretarja Juridike ,  
Indira Beqa,

Gjyqtarja,  
Zajrete Muhaxheri

**Këshilla juridike:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.